



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1188/10 prot

Datë 12.07.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 647/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.07.2022 me

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-24565-04-11-2022, me objekt: “Blerje kazane per mbetjet urbane”, me fond limit 29.020.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 06.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës  
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

**Ankimues:** BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK.  
Rruga Nasi Pavllo, Pallati 15/1, Shkalla.1, Apartamenti nr.1, Tiranë

**Subjekt i Interesuar:** “Zeqiri” SHPK  
Lagjja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Fier

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.04.2022 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-24565-04-11-2022, me objekt: “Blerje kazane për mbetjet urbane”, me fond limit 29.020.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 06.05.2022 nga autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan.

II.2. Në datën 06.05.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 31.05.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “GERARD - A” SHPK	21,090,000 lekëpa tvsh skualifikuar
2. “ZEQIRI” SHPK	22,390,000 lekë pa tvsh kualifikuar
3. “N.N.Z.K.Shkodra” SHPK	23,298,000 lekë pa tvsh skualifikuar
4. “LEKA 2007” SHPK	25,740,000 lekë pa tvsh skualifikuar
5. BOE “DU&CO” SHPK & “RADIKA” SHPK	25,800,000 lekë skualifikuar
6. BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK	28,820,000 lekë kualifikuar

II.4. Në datën 31.05.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Njoftimin e Fituesit”, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK.

II.5. Në datën 03.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1188 prot e BOE Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK, për procedurën e prokurimit E hapur” me Nr. REF-24565-04-11-2022, me objekt: “Blerje kazane per mbetjet urbane”, me fond limit 29.020.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

***Specifikimet teknike: Kazane metalik per mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra***

- *Spesori i llamarines te jete 1.5 - 2 mm.*
- *Kontenieri te kete 4 rrota gome të kthyeshme, te ndertuara me material gomë plastike, bashke me kuzhineta, dhe kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 300kg;*
- *Ne kornizen e sipërme te perdoret profil me permasa 40 x 30 x 1,5mm.*
- *Kontenieri te jete në gjendje të durojë kushtet klimaterike te ndryshme, për të gjithë përbërsit,dhe temperatura nga -20°C deri +50°C.*

***Specifikimet teknike: Kazane plastik per mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra.***

- *Permasat e kontenierit: Lartesia: 1340-1350 mm; Trashesia/Thellesia: 1050-1080 mm;Gjeresia: 1350-1380 mm.*
- *Trupi i kontenierit te ndertohtet nga material plastik (HDPE), jo i demshem nga rrezet UV, dhe rezistent ndaj temperaturave te ulta (deri ne -30°C) dhe te larta (deri ne +80°C).*

- *Pesha e kontenierit 44-48 kg*

***Specifikimet teknike: Kosha metalik per mbetje urbane kapacitet 30 Litra.***

- *Spresori i llamarines te kontenierit: jo me pak se 1.2 mm.*
- *Lartesia e kolones te kontenierit do te jete jo me shume se 90 cm. Koshicigareve, permasat jane: gjeresia e koshit 9 cm, gjatesia 9 cm dhe lartesia 19 cm. Fllanxha bashkohet me një tub çeliku Ø 60, 2 mm i trashë dhe 90 cm i larte.*

II.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave më datë 31.05.2022.

II.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 03.06.2022 operatori ekonomik ankimues BOE Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

II.9. Në datën 08.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar shkresa me objekt “Argumentat e pales së interesuar për ankmin e paraqitur pranë KPP dhe AK” me nr.1188/3 prot., datë 08.06.2022 e operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK,

II.10. Në përfundim të afatit ligjor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1188/4 prot., datë 15.06.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e BOE Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së BOE Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK.

II.11. Nëpërmjet shkresës me datë 28.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1188/6 prot., datë 24.06.2022, me objekt “Kërkesë për informacion”, është depozituar nga operatori ekonomik i interesuar “Zeqiri” SHPK pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht citoj: “[...] Pasi kemi qene te legjitimuar si pale kemi paraqitur argumentat tona ne lidhje me pretendimet e ankimuesit sa i përket kërkesës së tij

*me shkresë nr. Prot. 2540/6 date 07.06.2022 pranë Bashkisë Durrës si dhe nëpërmjet postës pranë KPP.*

*Deri me sot datë 24.06.2022 nuk kemi marrë njoftim për shqyrtimin e ankimit nga ana e Bashkisë Durrës si dhe vendimin përkatës të kësaj bashkie kjo në bazë të legjislacionit si më poshtë [...]”.*

II.12. Nëpërmjet shkresës me nr. 5563/1 prot., datë 28.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1188/7 prot., datë 01.07.2022, me objekt “*Dërgim Informacioni*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK dhe me Vendimin nr. 2540/9 prot., datë 14.06.2022, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, konkretisht citoj:

#### *Vendosi*

*Pranimin e pjesshëm të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomik “Start Co” Shpk & “Luar Bros” Shpk si më poshtë:*

*1. Specifikimet teknike: Lazane metalik per mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra*

- *Spesori i llamarines te jete 1.5 – 2 mm.*
- *... kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 300kg.*
- *Ne kornizen e sipërme te perdoret profili me permasa 40 x 30 x 1,5mm.*
- *Kontenieri te jete në gjendje të durojë kushtet klimaterike te ndryshme, për të gjithë përbërësit,dhe temperatura nga -20 °C deri +50 °C.*

*2. Specifikimet teknike: Kazane plastik per mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra*

- *Permasat e kontenierit: Lartesia: 1340-1350 mm;*
- *...rezistenta ndaj temperaturave te uleta (deri ne -30 °C) dhe te larta (deri ne + 80°C).*
- *Pesha e kontenierit 44-48 kg*

*3. Specifikimet teknike: Kosha metalik per mbetje urbane kapacitet 30 Litra.*

- *Spresori i llamarines te kontenierit: jo me pak se 1.2 mm.*
- *Koshicigareve, permasat jane: gjerësia e koshit 9 cm, gjatesia 9 cm dhe lartesia19 cm. Fllanxha bashkohet me një tub çeliku 2mm i trashë dhe 90 cm i larte.*

III.14. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1188/8 prot., datë 04.07.2022 i ka kërkuar autoritetit kontraktor paraqitjen e provave për të dokumentuar datën e dërgimit të aktit të njoftimit të vendimit nr. 2540/9 prot datë 14.06.2022 operatorit ekonomik të interesuar, që preket nga vendimarrja juaj “ZEQIRI” SHPK.

III.15. Nëpërmjet shkresës me nr. 2540/13 prot., datë 07.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1188/9 prot., datë 05.07.2022, me objekt “Dërgim Informacioni”, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës, (printim nga e-mail me datë 30.06.2022), të njoftimit dërguar operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK dhe me Vendimin nr. 2540/9 prot., datë 14.06.2022, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

III.2. Lidhur me argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK, respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në datën 08.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar shkresa me objekt “Argumentat e pales së interesuar për ankmin e paraqitur pranë KPP dhe AK” me nr.1188/3 prot., datë 08.06.2022 e operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK ku ka paraqitur respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III.2.2. Me shkresën nr. 5563/1 prot., datë 28.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1188/7 prot., datë 01.07.2022, me objekt “Dërgim Informacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit lidhur me trajtimin e ankesës të BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimesit.

III.2.3. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit me vendimin Vendimin nr. 2540/9 prot., datë 14.06.2022, ka vendosur:

*[...] 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomik “Start Co” Shpk & “Luar Bros” Shpk si më poshtë:*

*[...]*

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1188/8 prot., datë 04.07.2022 i ka kërkuar autoritetit kontraktor, nëse ky i fundit ka vënë në dijeni operatorët ekonomikë të interesuar për vendimin e marrë të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës, referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”.

III.2.5. Me shkresën nr. 2540/13 prot., datë 05.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1188/9 prot., datë 07.07.2022, autoriteti kontraktor na informon, se konkretisht citoj: “[...] Refeuar, VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” mdryshuar, neni 101, nga personi përgjegjës për prokurimin është njoftuar operatori ekonomik i interesuar “ZEQIRI” shpk për vendimin nr. 2540/9 prot. Datë 14.06.2022 të KSHA-së, në adresën e e-mail zyrtar dhe në adresën e administratores. [...]”, e-mail datë 30.06.2022 bashkëlidhur.

III.2.6. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:

*“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

*2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.*

*3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:*

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

*4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

*5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.*

*6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”*

III.2.7. Lidhur sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në kushtet kur operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK, ka paraqitur argumente pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor në përputhje me nenin 113 të ligjit për prokurimin publik, në kushtet kur ankesa është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor, këtij të fundit i ka lindur e drejta e ankimit në përputhje me nenin 114 pika 5 pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstatoi shkelje procedurale nga ana e autoritetit kontraktor në drejtim të kryerjes së veprimeve procedurale të parashikuara nga neni 114 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ku nënvizohet se: *“Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”* KPP gjen me vend të nënvizojë se *ratio*



*legis* e njoftimit të operatorëve ekonomikë të interesuar nga ana e autoritetit kontraktor, krahas parimit të transparencës në procedurat e prokurimit publik, lidhet ngushtësisht me momentin procedural të lindjes së të drejtës për të ushtruar mjetet ligjore administrative, sikundër është ai i ankimit administrativ procedura dhe afatet e të cilit rregullohen në *lex specialis*, ligjin për prokurimin publik. Në këto kushte, KPP me anë të shkresës me nr. 1188/6 prot., datë 04.07.2022 i ka kërkuar autoritetit kontraktor vënien në dispozicion të çdo akti që vërteton njoftimin e operatorit ekonomik të interesuar mbi njoftimin e vendimit me nr. 2540/9 prot., datë 14.06.2022. Me anë të shkresës nr. 2540/13 prot., datë 05.07.2022, protokolluar me tonën 1188/9 prot., datë 07.07.2022, autoriteti kontraktor ka vendosur në dispozicion bashkëlidhur shkresës (printim nga e-mail, datë 30.06.2022), ku vërtetohet dërgimi i njoftimit të vendimit të KSHA-së. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK janë paraqitur pretendimet në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, por në referim të nenit 114 e konkretisht pikës 5 dhe 6 të tij në të cilin parashikohet shprehimisht se: “[...]5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.[...]”,operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me argumentet e paraqitura pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së, pavarësisht se ky i fundit kreu të gjitha veprimet procedurale nëpërmjet komunikimit me autoritetin kontraktor, për tu informuar nëse janë zbatuar me perpikmëri parashikimet ligjore në lidhje me trajtimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor. Në këtë kuadër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afateve të parashikuara në nenin 114 pika 5 të ligjit për prokurimin publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 , pika 1 dhe 2 e nenit 115 dhe neni 118 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga e BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “*E hapur*”, me Nr. *REF-24565-04-11-2022*, me objekt: “*Blerje kazane per mbetjet urbane*”, me fond limit 29.020.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 06.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Start Co” SHPK & “Luar Bros” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**